

ZGJEDHJET

VOTA JOJE

ZËRI YJ


Voto
edhe
ti!



ELEMENT KRYESOR
NË DEMOKRACI

NE NË DEMOKRACI

GRESA (12), NORA (12), FLATRA (12), VALËZA (13), ELTIONA (13), AMALE (12), ALTIN (12),
FLORIJAN (13), URIM (12)



Ju ftojmë të lexoni më poshtë, nëse dëshironi të mësoni disa informata të dobishme rreth demokracisë

Ne ndihemi me fat dhe të lumtur që e kemi demokracinë. Kemi të drejta, jetojmë të lirë, jetojmë në paqe, etj. Të gjitha këto falë demokracisë.

Nëse demokracinë e paramendojmë si shtëpi, të gjithë njerëzit pavarësisht racës, fesë, moshës, gjendjes ekonomike apo edhe kombit, do të mund të strehoheshin në këtë shtëpi të madhe e mikpritëse. Kjo sepse për demokracinë, nuk ka rëndësi raca apo feja. Ajo i pranon të gjithë ashtu siç janë. Ndërkaq blloqet apo tullat e kësaj shtëpie do të ishin: respekti, barazia, toleranca, paqja, solidariteti, etj. Këto janë elementet e demokracisë. Në bazë të këtyre elementeve ne jetojmë. Të gjithë ne kemi të drejtë të shkojmë në shkollë, të marrim pjesë në aktivitete të ndryshme, madje në të ardhmen edhe të punësohemi. Ndonëse në të kaluarën, gratë nuk kanë pasur të drejtë të punojnë, sot edhe ato janë të barabarta në gjithçka, edhe në vendimmarrje shtetërore. Kjo tregon se sa lart demokracia i ngrit të gjithë njerëzit, pa dallime.

Fillet e saj demokracia i ka pasur në vitin 507 para erës sonë, në kryeqytetin e Greqisë, Athinën. Siç e përmendëm edhe më lart, edhe në këtë kohë gratë nuk kanë pasur të drejtë vote. Këtë të drejtë e kanë pasur vetëm burrat e pasur. Duke i lënë kështu anash të varfërit, të moshuarit dhe kuptohet gratë.

Dy format e demokracisë janë: demokracia përfaqësuese dhe ajo e drejtpërdrejtë. Forma përfaqësuese është kur populli i zgjedh përfaqësuesit me anë të votës. Ndërkaq, demokracia e drejtpërdrejtë është kur populli i merr vendimet direkt. Pa dyshim që vendi ynë ka demokraci përfaqësuese. Megjithatë, meqë demokracia përfaqësuese ka dy sisteme (sistemin parlamentar dhe atë presidencial) ne kemi sistemin parlamentar. Kjo për shkak se Presidenti në vendin tonë, zgjedhet nga deputetët. Për ne demokracia është jashtëzakonisht e rëndësishme. Prandaj, ne do ta ruajmë dhe do ta çmojmë. Fundja, demokracia është sistem i qeverisjes ku udhëheqim ne. Andaj, demokracia është e jona.



Autorët e artikullit

NE JEMI ATA QË VENDOSIM

ANISA (12), BLEARTA (12), ADONIS (13), GRANIT (13), ALBIN (13), RIGON (12), BLENDINA (13),
EDONA (13), MONIKA (14)

Nëse dëshironi të dini se si është të jetosh i lirë dhe të kesh mundësinë të bësh zgjedhje të ndryshme në jetë, atëherë lexojeni këtë artikull

Ne jemi nxënës të klasës së VII-të nga „Shkolla e Gjelbër“. Grupi ynë sot ka diskutuar për rëndësinë që kanë vendimet tona në jetën tonë.

Ne pas 2 vjetëve, kemi të drejtë të vendosim për shkollën e cila neve na pëlqen apo dhe na përshtatet. Disa nga ne pëlqejnë sportin, e disa të tjerë shkencat natyrore. Njëri nga shokët e grupit tonë pëlqen klubin e futbollit, ndërsa një tjetër pëlqen klubin e karatës. Pra, secili prej nesh shpreh mendimet duke treguar preferencat e tij/saj. Këtë të drejtë të shprehjes së mendimit na e mundëson demokracia.


Kosova është vend demokratik me sistem parlamentar, ku populli vendos me anë të votave se kush do ta

përfaqësojë atë. Këta përfaqësues janë deputetët. Kandidatët për deputetë para se të bëhen zgjedhjet dalin në fushata parazgjedhore, për t'i dhënë premtime popullit. Sipas grupit tonë, kandidatët duhet të punojnë dhe t'i përfaqësojnë interesat e popullit, duhet të jenë besnik dhe të sinqertë. Po ashtu, premtimet e bëra duhet t'i mbajnë. Vota është e rëndësishme për shkak se me anë të votës ne zgjedhim udhëheqësit (përfaqësuesit) e vendit.


Një mesazh që do të japim është pasi të gjithë kemi të drejta të barabarta, ne duhet t'i zbatojmë ligjet, të kemi durim e mbi të gjitha tolerancë. Pra, në demokraci fuqia është e popullit.



E drejta e votës në demokraci



Jemi të lirë të flasim atë që mendojmë



Elementet e demokracisë



Gazetarët e rinjë

KONTRIBUTI I QYTETARËVE NË SHTETIN TONË

ARIAN (), JON (13), VERONITA (12), ERMAL (12), DONJETA (12), XHEMAL (13), BLERONA (13),
 NUHI (12), KALTRINA (13), ELVIR (13)



Kosova ka një rini të shëndoshë dhe shumë punëtoare, prandaj çdo njëri prej nesh mund të ndihmojë në zhvillimin e shtetit

Çdo qytetar ka nevojë të shprehet lirshëm. Të gjithë qytetarët kanë të drejta dhe përgjegjësi. Secili prej tyre, ka nevojë të jetojë në mënyrën se si ai vetë e zgjedh. E këtë, mund ta përjetojmë vetëm në demokraci. Për të qenë qytetar aktiv, duhet të aktivizohemi të gjithë ne. Për shembull, ne nxënësit e „Shkollës së Gjelbër“ më datën 22 prill, kemi dalur në sheshin e qytetit për të shpërndarë fletushka, të cilat përmbanin këshilla se si ta mbajmë qytetin të pastër. Gjithashtu, kemi shpërndarë çanta, bukë dhe ujë. Kjo u mundësua me ndihmën e Drejtorisë së Shkollës tonë dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Disa nga të drejtat e qytetarëve janë: e drejta e votës, e drejta e shkollimit, e drejta e argëtimit, e drejta e jetesës, e shumë të drejta të tjera. Ndërsa, si përgjegjësi mund ta marrim shembull uniformën e shkollës, e cila në një farë forme na bën më të veçantë nga shkollat e tjera. Ngjyra e uniformës tonë ka një domethënie shumë të madhe, e cila lidhet pikërisht me qytetarinë aktive. Pra, ka të bëjë me gjelbërimin e qytetit.

Në një vend demokratik, gjithashtu ka edhe rregulla të cilat ndryshe i quajmë ligje. Këto ligje janë të formuara për ta rregulluar jetën tonë. Prandaj, ne duhet

t'i zbatojmë këto rregulla medoemos.

Për fund kemi një mesazh për lexuesit e këtij artikulli: thuaj ndal ndotjes së ambientit dhe bëhu i gatshëm të veprosh për një ambient të pastër.




Vullneti i qytetarëve për një vend të gjelbëruar



Autorët e grupit të qytetarëve aktiv

PUSHTETET E NDARA DEMOKRATIKE

LINOR (12), ERIONA (12), AGNESA (13), RINOR (13), RONA (12), ERMIRA (12), BLENDA (13), AID (13), FLORENT (12)



Pushteti në demokraci është konceptuar si një mënyrë qeverisje në një shoqëri, pa qenë e nevojshme të përdoret forca apo dhuna

Demokracia është sistem i qeverisjes, ku populli ka rolin kryesor, sepse ai vendos me anë të votës, se cilët deputetë do të jenë në Kuvend. Me një fjalë, demokracia është udhëheqje e popullit, nga populli, për popullin.

detyra dhe përgjegjësi të ndryshme. Prandaj, edhe janë të ndara në mënyrë që secili t'i kryejë detyrat e veta dhe të mos ndikojnë tek njëra-tjetra.

Kuvendi si Pushtet Legjislativ është i zgjedhur direkt nga populli në zgjedhjet e lira. Ky pushtet ka shumë fuqi, sepse detyrat kryesore të Kuvendit janë: krijimi i ligjeve të reja, zgjedhja e Qeverisë dhe Presidentit, etj. Siç e thamë, Qeveria është Pushteti Ekzekutiv. Detyrë kryesore e Qeverisë është t'i ekzekutoj ligjet që i miraton Kuvendi. Aty punojnë Kryeministri, ministrat, etj. Edhe Qeveria i ka punët e ndara me anë të ministrive. Pushtetin Gjyqësor e përbëjnë gjykatat, të cilat kanë për detyrë të ndajnë drejtësi. Sistemi gjyqësor te ne ndahet në Gjykatën Themelore, Gjykatën e Apelit dhe atë Supreme. Si përfundim, ne mendojmë që sistemi demokratik i qeverisjes, është sistemi më i mirë për ta udhëhequr një shtet.



Demokracia në vete përfshin ligjet, të drejtat themelore, barazinë shoqërore etj. Në një vend demokratik pushteti është i ndarë në tri degë. Këto degë janë Pushteti Legjislativ i cili është Kuvendi, Pushteti Ekzekutiv i cili është Qeveria dhe Pushteti Gjyqësor, i cili përfaqësohet nga gjykatat.

Kjo ndarje e pushtetit bëhet në mënyrë që shteti të funksionojë më mirë. Por, si funksionon shteti më mirë kur është pushteti i ndarë? Këto pushtete kanë



Autorët e këtij atikulli



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Shkolla e Gjelbër“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë